

ANALIZA PËR VITIN 2019

DEPARTAMENTI JURIDIK

Në zbatim të ISSAI 1, Deklarata e Limës, neni 16 i saj “Raportimi në Parlament dhe ndaj publikut të gjerë”, të ISSAI 12 “Vlerat dhe dobitë e SAI-ve: të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve”, Parimi 4 “Raportimi mbi rezultatet e auditimit, duke mundësuar publikun për të mbajtur qeverinë dhe subjektet e sektorit publik të përgjegjshëm”, të ISSAI 20 “Parimet e transparencës dhe të përgjegjshmërisë”, në datën 31.01.2020, në orën 12.30, në ambientet e KLSH-së, u zhvillua analiza vjetore e Departamentit Juridik.

Në këtë analizë morën pjesë, anëtarët e Departamentit Juridik, Sekretari i Përgjithshëm Znj. Luljeta Nano dhe Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë Z. Gjovalin Preçi. Në fjalën që mori Drejtori i Departamentit Juridik, Z. Koço Sokoli bëri një përmbledhje të punës së departamentit përgjatë vitit 2019 si më poshtë



Proceset gjyqësore penale

Gjatë vitit 2019 prioritet i Departamentit Juridik, ndër të tjera ka qenë ndjekja e proceseve gjyqësore për të cilat KLSH ka iniciuar kallëzimet/indiciet penale, si dhe ndjekja e çështjeve gjyqësore ku KLSH ka marrë pjesë si palë e tretë dhe ecuria e tyre.

Në këto procese gjyqësore KLSH është përfaqësuar nga Juristët e Departamentit dhe na ezulton se përgjatë vitit 2019 KLSH është përfaqësuar në të gjitha Proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjyqimit. Po kështu me mjaft rigorizitet janë ndjekur procedurat e ankimimit në vecanti për proceset ku KLSH ka qenë kallëzues për vepra të ndryshme penale.

Proceset gjyqësore në Gjykatat Administrative me palë të tretë KLSH.

Roli i KLSH-së në këto procese gjyqësore:

- Roli monitorues i KLSH-së në zbatimin e rekomandimeve.
- Certifikimi i gjetjeve me vendime gjyqësore.
- Arkëtimi i dëmit.
- Parandalimi i efekteve negative financiare.

Problematikat:

- Kërkesë padi me të meta, të subjekteve të audituara.
- Juriste të subjekteve objekt gjykimi jo kompetent për mbrojtje efektive.
- Mosprezenca e juristëve të subjekteve të audituara në seancat gjyqësore.
- Ngritja e padive jashtë afateve ligjore.
- Mos ankimim i vendimeve nga subjektet e audituara në disfavor të subjekteve shtetërore.
- Mosparaqitja e provave (detyrimi i subjektit shtetëror, sipas Ligjit “Për gjykatat administrative”).

Në vijim të analizës e mori fjalën Znj. Nano e cila bëri present disa problematika që ishin konstatuar gjatë procesit të administrimit të dosjeve gjyqësore që juristët e Departamentit Juridik kishin në ndjekje, si dhe lidhur me përdorimin/aplikimin e sistemit SIMMPA/RevZone për modulën “Ndjekja e Çështjeve Gjyqësore”.

Në përfundim të analizës u konkludua me objektivat të cilat do të duhet të përmbush Departamenti Juridik për vitin në vijim.